



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 1140 Prot.

Ballsh, më 28.02.2022

VENDIM

NR. 14 DATË 28/02/2022

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 31, DATË 19.04.2018 “PËR MIRATIMIN E VLERËS SË SHPRONËSIMIT TË QYTETARËVE ALBERT MEÇANAJ, ADRIAN HAZIZAJ, KASTRIOT TAULLAJ NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PROJEKTEVE TË BASHKISË MALLAKASTËR”

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” i ndryshuar, VKM-së nr. 138, datë 23.03.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të projektit “Rikualifikimi Urban i lagjes 28 Nëntori të qytetit Ballsh, Mallakastër”, si dhe referuar shkresës nr. 44 prot., datë 11.01.2022, të Komisionit të Posaçëm për Shpronësim, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 164 prot., datë 12.01.2022, situacionit të punimeve të objektit të z. Adrian Hazizaj,

VENDOSI

1. Në gërmën b, pika 1 e Vendimit nr. 31, datë 19.04.2018 “Për miratimin e vlerës së shpronësimit të qytetarëve Albert Meçanaj, Adrian Hazizaj, Kastriot Taullaj në kuadër të zbatimit të projekteve të Bashkisë Mallakastër”, bëhet ky ndryshim:
Miratimin e vlerës paraprake të shpronësimit si më poshtë (referuar situacionit të punimeve të objektit të z. Adrian Hazizaj):
 - a. Z. Adrian Hazizaj - Vlera Totale e shpronësimit = 535 670 (pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë.

Vlerësimi paraparak për sipërfaqen e objektit njësi shërbimi është kryer në bazë të situacionit të punimeve referuar VKM-së nr. 138, datë 23.03.2000 .



KRYETAR

Mbarime Isufaj